

PËRKUJTIMORE
me rastin e 10-vjetorit të vdekjes



INJAC ZAMPUTI
1910-1998

I. Zamputi u lind më 12 shkurt 1910 në Shkodër në një familje të mesme. Studioi në Kolegjin Saverian të Jezuitëve në qytetin e lindjes, ku u shqua për korrektesë, zell shembullor dhe rezultate të larta. Duke parë të gjitha këto aftësi të tij, sapo mbaroi studimet, drejtuesit e kolegjit e emëruan mësues të letërsisë shqipe po në atë shkollë. Pati kështu fatin që njëzetënjëvjeçar të bëhej koleg i poetit të madh, Dom Ndre Mjedës.

Veprimtar i përkushtuar në fushën e artit dhe të letërsisë, I. Zamputi mori pjesë në të gjitha veprimtaritë teatrale e muzikore në qytetin e tij, fillimisht si amator, mandej si drejtues, si aktor dhe violinist, shkrimtar dhe regjisor.

Nisi të botojë herët në fushën letrare, me pseudonime të ndryshme e në organe të shumta si në revistat “Leka”, “Hylli i Dritës” etj.

Më 1940 botoi vëllimin e parë me novela “Zemra njerëzish”, më 1944, vëllimin e dytë “Atje, nën hijen e Rozafës” dhe melodramën “Damjani himarjot”. Shkroi vazhdimisht poezi epike, studime e drama pa iu larguar deri në fund të jetës së tij dashurisë për letërsinë, vazhdoi me dramën “Guri i themelit” dhe e mbylli këtë fushë të rëndësishme të

krijimtarisë letrare me dy studimet themeltare “Fishta – koha, njeriu, vepra” dhe “Ekskursion në dy vepra të Kadaresë”.

Pas luftës, më 1945, punoi fillimisht si drejtues i Shtëpisë së Kulturës në Shkodër, kurse më 1946-1948 si mësues i letërsisë në Liceun e Gjirokastrës.

Me formimin e Institutit të Shkencave u thirr në Tiranë për të vazhduar punën e tij shkencore, të cilën e pat nisur së bashku me At Zef Valentinin, porsa qe diplomuar në Trieste, për shkenca politike, duke mbrojtur temën historike “700-a Veneciane dhe Shqipëria”.

Tema e historisë së mesjetës u bë përgjithmonë epiqendra e studimeve të tij, fushë shkencore që i kushtoi dyzet vjet punë, kërkime me pasion, ku u shqua përherë për nivelin e lartë shkencor.

Ndër punimet e para qenë zbërthimi i alfabetit të dorëshkrimit të Anonimit të Elbasanit, transkriptimi dhe komentimi i tij, zbërthimi i alfabetit të panjohur të një poezie me përmbajtje bektashiane të shekullit XIX dhe, njëherësh, realizimi i librit “Përpjekjet e shqiptarëve për liri e pavarësi në shekujt XVI-XVII”, etj.

I. Zamputi mbeti njohësi më i mirë i latinishtes mesjetare, transkriptuesi e interpretuesi i shkrimeve të periudhës së shekujve XIV-XVII, duke zbuluar në këto shekuj vlerat e vërteta historike e kombëtare të popullit tonë, botuar në një varg veprash të shquara në serialin “Dokumente për historinë e Shqipërisë”, herë me bashkautor e herë vetëm, gjithmonë i aftë për t’u dhënë zgjidhje problemeve më të koklavitura gjuhësore e historike. Është për t’u përmendur edhe gatishmëria e tij e spikatur për të ndihmuar studiuesit e rinj.

Ndonëse i njohur si studiues e historiani përmes veprave të sipërpërmendura e kumtesave të vazhdueshme nëpër sesione shkencore, apo si ligjërues në emisione radiofonike, I. Zamputi mbeti i pavarësuar nga qarqet zyrtare të kohës.

Me ardhjen e demokracisë, I. Zamputi u ndje i lirë, përktheu romanin e Pashko Vasës “Burgimet e mija”, shkroi veprat e shquara kritike dhe botoi në revistën “Hylli i Dritës” studimin madhor: “Çështje të fillimit të gjuhës dhe letërsisë shqipe”.

I. Zamputi u nda nga jeta më 28 shkurt 1998 në Tivoli të Italisë dhe, sipas porosisë së tij të fundit, u soll të prehet përgjithmonë në Shqipëri (Tiranë), në atë vend që i kushtoi jetën dhe veprën e tij.

Musa VYSHKA
Marenglen VERLI

